Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-459/6
-VI-
Data Datum Date 13.05.2019

# Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

*Prishtinë, Datë: 08.05.2019*
*Nr.020-459/5*

**Për: Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllogocit**
**Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit**

**Lënda:** Shkresë përcjellëse

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar, **Vendimin Nr.354-22099 për lejimin e rrënimit të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadatrale Drenas, ish objektit për sigurime sociale,** i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Gllogocit dhe nënshkruara nga Kryesuesi i KK të Gllogocit, më qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë.

Duke u bazuar në nenin 7 të Rregullores (QRK) Nr. 01/2016 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 26.04.2019, ka përcjellë aktin e lartshënuar për vlerësim të ligjshmërisë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Bashkangjitur gjeni Raportin nga MMPH lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë.

Me respekt,

**Rozafa Ukimeraj**
Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së

*Kopje: Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave*
*Arkivit të MAPL-së*

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING

Nr. Prot. 2480-2/19
Data 02.05.2019
Prishtinë / a

# Republika e Kosovës

**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

*Qeveria – Vlada - Government*

***Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor***
***Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja***
***Ministry of Environment and Spatial Planning***

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Data 07.05.2019
-01- 020-459/5

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Adriana Hoxhiq, Ministre në MAPL<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL | |
| Cc: | Njësia për Administrimin e dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e dokumenteve në Komunë<br>Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | |
| Përmes: | Fatmir Matoshi, Minister i MMPH-së<br>Arben Çitaku, Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së | |
| Nga: | Vlora Osaj, u.d. Drejtor i Departamentit Ligjor,<br>Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor | Datë:<br>26.04.2019 |
| Lënda: | Kërkesë për Rishqyrtimin e Ligjshmërisë | |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

E nderuar Ministre,
E nderuar Sekretare,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi i Kuvendit të Komunës së Drenasit 12 Nr. 354-22099 datë 25.04.2019, për lejimin e rrënimit të objektit që ndodhet në parcelën 767-5, në zonën kadasrale Drenas, ish objekti për sigurime sociale. |
| I miratuar me datë: 25.04.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL me datë: 25.04.2019 |
| I dërguar për shqyrtim në MMPH, me datë: 26.04.2019 |

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.